



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1456/1 Prot.

Tiranë, më 15.10.2021

V E N D I M

Nr. 202, Datë 15.10.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 179, datë 05.10.2021, të paraqitur nga D.H¹ kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “jetesës me HIV/AIDS”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë dhe komunikimit me telefon², subjekti ankues në mes të tjerash, informon se ai vetë nuk ka aplikuar për punonjës policie, por është njohur me thirrjen për aplikime si të bëhesh punonjës policie, të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në këtë thirrje, janë përcaktuar dhe kriteret skualifikuese të aplikantëve për të qenë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit. Një ndër kriteret skualifikuese është nëse personi aplikant diagnostikohet me sëmundje ngjitëse HIV. Sipas ankuesit ky kriter skualifikues përbën diskriminim të hapur të personave të infektuar me HIV, ndërkohë që këto persona nuk përbëjnë rrezik infektimi për të tjerët në rastin kur ndodhen në trajtim mjekësor.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmarrjen e një hetimi administrativ për këtë çështje.

¹ Ankuesi është Koordinator Kombëtar për të Rinjtë Romë.

² Komunikimi i inspektorit të çështjes me ankuesin, në datë 13.10.2021.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cënohen nga ky veprim apo mosveprim.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se D.H nuk ka identifikuar dhe evidentuar faktin se interesat e tij të ligjshme janë cënuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, lidhur me pretendimet e tij për diskriminim, për shkak të kriterit skualifikues të përdorur nga DPPSH në procesin e aplikimit për punonjës policie, në shkollën bazë të policisë.

Bazuar në dispozitat e mësipërme dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se D.H nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për çështjen e sipërpërmendur, pasi nuk legjitimohet për kryerjen e ankesës për të.

Bazuar në nenin 33/4, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33/4, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ju informon se, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 145, datë 12.11.2019 të bërë nga M.T kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Vendimin³ nr. 42, datë 29.04.2020, ka konstatuar diskriminimin e ankuesit në të drejtën për arsim, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në këtë vendim në mes të tjerash, Komisioneri ka vendosur që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për heqjen e kriterit s’kualifikues për personat pozitiv me hepatit B (aktiv ose jo aktiv), dhe për hartimin e politikave për parandalimin dhe trajtimin e hepatiteve virale dhe HIV/AIDS në Policinë e Shtetit.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma c), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri do vlerësojë fillimin e shqyrtimit kryesisht të çështjes, për të hetuar kriterin për skualifikimin e aplikantëve të diagnostikuar me sëmundje ngjitëse HIV.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 44, pika 2, nenin 65, gërma b) të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b

³ www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-nr.-42-datë-29.04.2020-M.T-kunder-Akademisë-së-Sigurisë-dhe-Drejtorisë-së-Përgjithshme-të-Policisë-së-Shtetit.pdf

dhe 10 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 179, datë 05.10.2021, të subjektit ankues D.H, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA